# MALLRAT KULTURORE

Çdo komb, çdo vend ka historinë e tij dhe mallrat kulturore me vlerë të madhe artistike, historike ose arkeologjike, që do të thotë njëkohësisht se ato kanë edhe vlerë të konsiderueshme financiare. Sidoqoftë ato janë pjesë e trashëgimisë kulturore të një vendi, dëshmi e evolucionit të identitetit të një kombi dhe prandaj duhet të respektohen, ruhen dhe mbrohen nga dëmtimet, vjedhjet, gërmimet klandestine, importi, eksporti e transferimi i paligjshëm i pronësisë dhe trafikimi.

## Cilat janë Mallrat Kulturore?

Mallrat kulturore janë të gjitha objektet arkeologjike, pjesët dhe mbetjet e monumenteve historike, dorëshkrime antike, pergamena dhe libra, vepra arti, koleksione dhe antika, etj. Çdo gjë që një vend e konsideron si pjesë të trashëgimisë së vet kulturore.

## Një nga tre format më fitimprurëse të krimit të organizuar

Kërkesa për pronë kulturore po shkakton rritje të krimit të artit, duke e bërë atë gjithmonë e më të përhapur. Vepra arti me vlerë, skulptura dhe artefakte arkeologjike merren, shiten dhe importohen shpesh në mënyrë të paligjshme në BE nga zonat e konfliktit. Me potencial të lartë fitimi dhe nivel relativisht të ulët rreziku, tregu i zi i veprave të artit është një nga tre format më fitimprurëse të krimit të organizuar. Piktura, statuja, sende fetare, relike, monedha, butona, vazo, libra, shpata dhe shumë vepra të tjera arti janë tepër të kërkuara, ku fitimi nga tregtia e tyre përdoret për financimin e terrorizmit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

**Siç citohet në Konventën e Hagës të vitit 1954: “Dëmtimi i pasurisë kulturore që i përket një populli nënkupton dëmtim të trashëgimisë kulturore i të gjithë njerëzimit”, duke e kthyer mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në përgjegjësinë tonë të përbashkët.**

**Mund të jetë duke ndodhur tani dhe mund të jetë duke ndodhur mu përpara syve tuaj. Ndërgjegjësohuni për shenjat, parandaloni Trafikimin e Paligjshëm të Mallrave Kulturore, bëhuni vigjilentë e vëzhgues dhe ndihmoni të përhapet fjala: TRASHËGIMIA NUK ËSHTË PËR T'U HUMBUR!**

**#noheritagetogo**

**ICOM Red Lists Database**

DCAF Geneva Centre for Security Sector Governance 20TH ANNIVERSARY

This material was produced within the framework of a project granted by the Royal Norwegian Government

www.dcaf-ljubljana.si www.dcaf.ch

DCAF Geneva Centre for Security Sector Governance 20TH ANNIVERSARY

# HEJ, ÇFARË KE ATY?

Luftojmë së bashku kundër Trafikimit të Paligjshëm të Mallrave Kulturore



## A DUHET TË JENI I DYSHUES?



## PERSONI DHE UDHËTIMI

**1. Sjellje e pazakontë**
- Persoana prezintă un comportament neobișnuit?

**2. A po shfaq personi sjellje të pazakontë?**
- A është e pazakonshme që një shtetas i atij vendi origjine të mbërrijë në atë PKK?

**3. Personat me rekorde kriminale**
- A është dënuar apo ka pasur ndonjëherë të bëjë personi me trafikim, kontrabandë, vjedhje apo falsifikim?

**4. Itinerari i udhëtimit (drejt / nëpërmjet / prej vendeve të pasura kulturalisht)**
- A shfaqet ndonjë anomali me itinerarin e udhëtimit të personit?
- A po mbërrin personi nga ndonjë vend i pasur kulturalisht?
- A ka qenë personi në ndonjë vend të pasur kulturalisht gjatë udhëtimit të tij?
- A udhëton shpesh personi në të njëjtat destinacione, veçanërisht për në vendet e pasura kulturalisht?

**5. Vendi i destinacionit**
- A po udhëton personi drejt një vendi të njohur për tregti kulturore?



## ARTIKUJ

**1. Lista e mallrave kulturorë më të zakonshëm të kontrabanduar**
- A ka personi në zotërim ndonjë nga artikujt e mëposhtëm: Monedha, skulptura, qeramikë, ikona, libra, bizhuteri?
- A ka personi që udhëton nga një vend me trashëgimi kulturore ndonjë artikull të listës së kuqe të ICOM?

**2. Sendet në zotërim janë të pista, të papastra, të lagura, me baltë**

**3. Dokumentacion me pikëpyetje**
- A i mungon personit dokumentacioni zyrtar ose shpjegimi i vlefshëm (prova) mbi origjinën e sendit në zotërim?
- A është i shkruar me dorë dokumentacioni për sendin në zotërim?
- A zotëron personi dokumentacion, i cili nuk korrespondon me sendin në zotërim?

**4. Origjina e artikujve**
- A pretendon personi që artikulli ka ardhur nga një vend arkeologjik, galeri apo muzeum?

**5. Identifikimi i zonave arkeologjike kombëtare të njohura**
- Persoana a achiziționat un obiect dintr-un loc (regiune, oraș) care nu are situri de excavare cunoscute sau instituții relevante din punct de vedere cultural?

**6. Transporti i pazakontë i sendeve**
- A është paraqitja e personit ose mënyra e transportit në kundërshtim me vlerën e mallrave që po transportohen (kontrolloni dokumentacionin për artikullin nëse është e mundur)?
- A po transporton personi ndonjë artikull në mënyrë të papërshtatshme, si për shembull pikturat të mbështjella, sendet në thasë që nuk janë shënuar saktësisht?



## PAJISJE NË ZOTËRIM

**1. Zotërimi i hartave, librave me faqe të shënuara ose skicave të një zone**
- A ka personi letërsi të zgjeruar (të shtypur dhe / ose në formë dixhitale) apo mjete të tjera më tepër se ç'është e zakonshme për udhëtarët për zbulimin e mallrave kulturorë?

**2. Zotërimi i pajisjeve të gërmimit**
- A ka personi sende të tilla e të ngjashme me detektorët e metaleve, lopata, furça, kova, pajisje rrëmimi, etj?

